

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “MIRËMBAJTJA E IMPIANTIT TË SHKARKIMIT TË
UJRAVE TË ZEZA NË NJËSINË E MJEKËSISË BËRTHAMORE”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

45259000-7- Riparime dhe mirëmbajtje impiantesh

**VLERA E FONDIT LIMIT: 13,028,675 (trembëdhjetë milion e njëzet e tetë mijë e
gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- a. 1 (një) inxhinier mekanik /elektrik
- b. 1 (një) teknik elektrikist
- c. 1 (një) teknik hidraulik/meکانik

Për punonjësin në pikën a duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme

Për punonjësin në pikën b, c duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme
- dokument që vërteton kualifikimin profesional për profilin përkatës (i vlefshëm)

Nga stafi teknik i kërkuar më sipër, të paktën 1 (një) nga punonjësit duhet të jetë i çertifikuar/trajnuar për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes së impiantit objekt prokurimi ose për impiante/sisteme të një natyre teknike të njëjtë apo ekuivalente.

Për të provuar përmbushjen e kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën/dëshminë e trajnimit ose dokumentacion tjetër ekuivalent (të vlefshme) që vërteton kualifikimin e kërkuar.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion stafin dhe personelin teknik të kualifikuar, të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin teknik është përcaktuar bazuar në analizën e specifikimeve teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor dhe në natyrën e shërbimeve që do të kryhen. Impianti objekt prokurimi përbëhet nga sisteme dhe komponentë mekanikë, elektrikë dhe hidraulikë, të cilët funksionojnë në mënyrë të ndërlidhur dhe kërkojnë mirëmbajtje periodike, parandaluese dhe korrigjuese, si dhe ndërhyrje teknike në rast defekti.

Kërkesa për 1 (një) inxhinier mekanik/elektrik është përcaktuar duke marrë në konsideratë nevojën për mbulimin në nivel inxhinierik të sistemeve dhe komponentëve kryesorë të impiantit. Pajisjet përbërëse të tij përfshijnë pompa, valvula dhe elemente të tjera mekanike, si dhe instalime, panele dhe elemente elektrike të komandimit dhe kontrollit. Për realizimin e shërbimit kërkohen njohuri profesionale për funksionimin e këtyre pajisjeve, vlerësimin teknik të problematikave dhe përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme. Për këtë arsye, është parashikuar që kërkesa të mund të përmbushet nga një inxhinier mekanik ose elektrik, si profile që lidhen drejtpërdrejt me natyrën dhe funksionimin e impiantit.

Kërkesa për 1 (një) teknik elektrikist lidhet me nevojën për kryerjen e kontrolleve dhe ndërhyrjeve teknike në instalimet dhe komponentët elektrikë të impiantit, përfshirë lidhjet dhe kabllimet elektrike, furnizimin, elementet e mbrojtjes dhe komandimit, si dhe pjesët elektrike të paneleve dhe pajisjeve. Ky punonjës është i nevojshëm për kryerjen e mirëmbajtjes periodike dhe ndërhyrjeve elektrike të parashikuara në specifikimet teknike, me qëllim ruajtjen e funksionimit normal dhe të sigurt të impiantit.

Kërkesa për 1 (një) teknik hidraulik/mekanik është përcaktuar për realizimin e shërbimeve që lidhen me pjesën mekanike dhe hidraulike të impiantit, përfshirë pompat, valvulat, tubacionet, lidhjet dhe komponentët e tjerë të kësaj natyre. Mirëmbajtja, riparimi dhe zëvendësimi, sipas rastit, i këtyre elementeve kërkon personel me kualifikim profesional në fushën hidraulike ose mekanike. Kërkesa që të paktën 1 (një) nga punonjësit e stafit teknik të jetë i certifikuar/trajnuar për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes së impiantit objekt prokurimi ose për impiante/sisteme të një natyre teknike të njëjtë apo ekuivalente është përcaktuar duke marrë në konsideratë karakteristikat teknike dhe mënyrën e funksionimit të impiantit. Përveç komponentëve mekanikë, hidraulikë dhe elektrikë, impianti përfshin edhe panele elektrike/elektronike dhe elemente të komandimit, kontrollit dhe sinjalizimit, të cilat funksionojnë në mënyrë të integruar me pjesën tjetër të sistemit.

Për këtë arsye, krahas kualifikimit profesional të stafit sipas profileve të kërkuara, vlerësohet e nevojshme që të paktën një nga punonjësit të ketë njohuri të dokumentuara, të përfituara nëpërmjet certifikimit ose trajnimit, për mirëmbajtjen e impiantit objekt prokurimi ose të impianteve/sistemeve të një natyre teknike të njëjtë apo ekuivalente. Kjo kërkesë siguron që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij personel me njohuri për funksionimin e integruar të sistemit dhe për ndërhyrjet e mirëmbajtjes në komponentët e tij, përfshirë edhe pjesën elektrike/elektronike të impiantit.

AK ka përcaktuar stafin teknik minimal të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, në përputhje me komponentët dhe ndërhyrjet e parashikuara në specifikimet teknike. Kërkesa synon të sigurojë që shërbimet e mirëmbajtjes të kryhen nga personel me kualifikimin dhe përgatitjen e nevojshme profesionale, me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt dhe të sigurt të impiantit gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë për përmbushjen e kriterit dhe për kualifikimin profesional të stafit të kërkuar.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH/UNI/DIN/EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi siguron që ofertuesi do të zbatojë procedura të strukturuar dhe të dokumentuara për realizimin e shërbimit, duek garantuar cilësi të qëndrueshme të shërbimit (mirëmbajtja, kontrolli, ndërhyrjet do të realizohen sipas standarteve teknike, pa devijime apo gabime). Implementimi i këtij standarti ndihmon në garantimin e transparencës dhe gjurmueshmërisë, optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve.

Standarti ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet se operatori ekonomik disponon një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me natyrën e shërbimeve objekt prokurimi.

Kërkesa lidhet me ndërhyrjet e parashikuara në specifikimet teknike, të cilat përfshijnë mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese, riparimin dhe zëvendësimin e komponentëve të impiantit, përfshirë panelet elektrike/elektronike, pompat, valvulat dhe tubacionet. Gjatë këtyre ndërhyrjeve mund të paraqiten rreziqe për shëndetin dhe sigurinë e personelit, të cilat kërkojnë zbatimin e masave dhe procedurave të përshtatshme parandaluese.

Disponimi i këtij standarti dëshmon se operatori ekonomik ka të implementuar një sistem për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve, marrjen e masave parandaluese dhe zbatimin e procedurave të sigurisë gjatë kryerjes së shërbimeve objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të realizojë shërbimin e mirëmbajtjes objekt prokurimi (sipas përcaktimeve në specifikimet teknike), duke e lënë impiantin në kushte të plota optimale pune.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke qenë se specifikimet teknike përcaktojnë standardet, parametrat dhe kërkesat që duhet të respektohen gjatë realizimit të shërbimit, nëpërmjet kësaj deklarate operatori ekonomik merr përsipër që çdo ndërhyrje, mirëmbajtje, testim apo kontroll të kryhet në përputhje me këto kërkesa. Gjithashtu, operatori ekonomik merr përsipër realizimin e plotë të mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese, përfshirë riparimet dhe zëvendësimet e nevojshme, me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt të impiantit gjatë periudhës së kontratës dhe lënien e tij në kushte të plota optimale pune.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, përllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuara nga titullari i autoritetit kontraktor “Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Në dokumentacionin e përcjellë nga AK përfitues rezulton se grupi i punës i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike, ka vlerësuar nevojën për t’u mbështetur në natyrën specifike teknike dhe radiologjike të impiantit, administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit teknik, verifikimin fizik të sistemit dhe komponentëve përbërës.

Referuar shkresës me Nr. __, ardhur nga Projektuesit mbikqyrësit e këtij sistemi, ____, në përgjigje të kërkesës. informacion të QSUT (shkresa nr....)..., ndër të tjera shpjegohet se:

Shkarkimit të ujërave radioaktive është një implant shkarkimi specifik që Sumbullon ujerat e zeza të njësive sanitare, të cilat perdoren nga pavijonet në të cilat diagnostikohen ose kryhen teste të ndryshme, duke përdorur reagentë radioaktivë që injektohen në mënyrë intravenoze ose merren nga goja nga pacientët, gjatë procedurës së analizave. Impianti synon të ulë përqëndrimin e përmbajtjes radioaktive përpara shkarkimit në rrjetin urban.

Ky Sistem është projektuar mbi bazën e referencave, përllogaritjeve, parametrave, kërkesave dhe vlerësimeve të specializuara të inxhinierisë Mjekësore dhe Fizikës Nukleare, duke marrë parasysh dhe rekomandimet impiantistike të kësaj godine.

Në përshtatje të këtyre referencave dhe parametrave funksionalë, për një funksion sa më të përshtatshëm dhe efektiv të këtij sistemi në tërësi, janë përllogaritur parametrat tekniko- mekanike dhe elektrike të nevojshme dhe janë implementuar pajisjet mekanike (pompat) dhe elektrike (panelet).

Sistemi është i automatizuar me një panel elektrik ku mund të monitorohen nivelet e të gjithë serbatorëve me sensorët përkatës. Gjithashtu, në mënyrë të automatizuar menaxhohet mbushja dhe shkarkimi i sinkronizuar i këtyre depozitave, duke garantuar neutralizimin e lëndëve radioaktive. Shkarkimi final bëhet

në gropën e pompave qendrore të shkarkimit të ujërave të zeza, për të vijuar më tej drejt kolektorit të rrietit të jashtëm të qytetit.

Specifikimet teknike/termat e references, projekti të përcjella nga AK përfitues janë pjesë e pandarë e DST.

Ndarja në Lote:

Është vendosur që procedura e prokurimit “E hapur” me objekt: “Mirëmbajtja e impiantit të shkarkimit të ujërave të zeza në Njësinë e Mjekësisë Bërthamore” të mos kryhet e ndarë në lote, nisur nga uniteti funksional i impiantit dhe nevoja për vijueshmëri, koordinim dhe përgjegjësi të qartë gjatë realizimit të shërbimit. Duke qenë se shërbimet e parashikuara përbëjnë një tërësi funksionale dhe lidhen me mirëmbajtjen e të njëjtit impiant, komponentët elektrikë, elektronikë, mekanikë dhe hidraulikë të të cilit janë teknikisht të ndërlidhur, ndarja e procedurës në lote do të fragmentonte përgjegjësinë teknike për diagnostikimin, ndërhyrjet, riparimet dhe pjesët e zëvendësuara, duke vështirësuar koordinimin dhe përcaktimin e përgjegjësisë në rast defekti.

Nënkontraktimi:

Bazuar në nenin 126 të LPP dhe nenit 89 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar, dispozita të cilat parashikojnë mundësinë e lejimit të nënkontraktimit për realizimin e një pjese të kontratës, vlerësohet se: Nënkontraktimi nuk vlerësohet i përshtatshëm, për shkak të natyrës së integruar të impiantit dhe ndërvlerësisë së komponentëve mekanikë, hidraulikë dhe elektrikë. Shërbimi kërkon ndërhyrje të koordinuara dhe respektimin e afateve të përcaktuara për konstatimin dhe korrigjimin e defekteve. Për këtë arsye, kërkohet përgjegjësi e drejtpërdrejtë dhe e unifikuar e kontraktorit për realizimin e shërbimit dhe funksionimin e plotë të impiantit gjatë gjithë periudhës së kontratës.

NJËSIA E PROKURIMIT